

VENDIM
Nr. 4, datë 29.2.2012

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KONSUMATORËVE PËR DISA KLIENTË TË VEÇANTË

(ndryshuar me vendim nr. 31, datë 27.4.2018; vendim nr.22, datë 24.4.2019)

(i përditësuar)

Në zbatim nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a." dhe Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të përcaktojë kategorinë e konsumatorëve sipas përkatësisë, për disa konsumatorë të veçantë, si më poshtë:

a) Trupat diplomatikë (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike) të trajtohen në kategorinë "ent publik".

b) *Komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) të trajtohen në kategorinë "Klientë familjarë". Këtu bëjnë përjashtim ato institucione dhe struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, të cilat do të trajtohen në kategorinë "Klient privat".*

c) Partitë politike (selitë dhe degët e tyre në qytete) të trajtohen si "Ent publik";

d) Shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., dhe çdo shoqëri tjetër shtetërore) të trajtohen si "ent privat".

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi